



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:064666

Datë: 13.12.2024

Numri i dokumentit: 06595475

**P.nr.1235/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Bujar Ahmeti dhe zyrtaren ligjore Dife Latifi, në çështjen penale kundër të pandehurës A.T nga fshati M, K e P, për shkak të veprës penale vjedhje, nga neni 313 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1257/23 të datës 09.03.2023, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar publik me datë 06.12.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Vjosa Bytyqi dhe të pandehurës A.T, me datë 09.12.2024 publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me datë 13.12.2024, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

***E pandehura,***

**A.T**, nga babai S dhe nëna T, mbiemri i vajzërisë se nënës H, i lindur me datë ... në fshatin M, K e P, ku edhe banon, si dhe me vendbanim edhe në F.K, e pa martuar, e pa punë, e gjendjes së mirë ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, e identifikuar me numër personal ...

**ËSHTË FAJTORE**

***Sepse:***

Me datë 17.10.2022, rreth orës 20:05 në Prishtinë, në rrugën "...", tek lokali "...", e pandehura A.T me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete, e njëjta hynë brenda në lokal pasi që i kishte çelësat, pastaj hynë në zyre nga ku aty merr para të gatshme në vlerë prej 120 (njëqindnjëzet) €, duke i shkaktuar të dëmtuarit dëm në vlerë prej 120 euro.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale *vjedhje, nga neni 313 par.1 të KPRK-së*.

Prandaj, kjo gjykatë në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39 par.1 pika 1.2, 46 par. 1 pika 1.1, 47, 48, 69, 70, nenit 313 par.1 të KPRK-së, nenit 242, 364 dhe 449 të KPP-së, të pandehurën e:

**G J Y K O N**  
**ME DËNIM ME KUSHT**

- I. Të pandehurës **A.T** i cakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditë, dhe dënimin me gjobë në shumën prej treqind (300) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen në afatin prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e pandehura brenda kësaj periudhe nuk kryen vepër të re penale.

- II. Obligohet e pandehura që të dëmtuarit D.A lidhur me kompensimin e dëmit t'ia paguaj shumën në vlerë prej 120 € (njëqindnjëzet euro) të cilën shumë e pandehura obligohet që ta paguaj në 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.
- III. Obligohet e pandehura që të paguajë shpenzimet procedurale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro), si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 € (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

#### *Rrjedha e procedurës penale.*

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj me numër PP.II.nr.1257/2023 të datës 09.03.2023 të pandehurën A.T e ka akuzuar për shkak të veprës penale vjedhje, nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Gjykata pas vlerësimit të kompetencës lëndore dhe territoriale dhe duke vepruar sipas aktakuzës, me datë 06.12.2024 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilin seancë prezent ishin Prokurori i Shtetit Vjosa Bytyqi dhe e pandehura A.T.

Në seancën e shqyrtimit fillestar gjyqtari i vetëm gjykuese e ka udhëzuar të pandehurën për të drejtat konform nenit 241 par.1 të KPP-së. Pas kësaj, Prokurori i Shtetit e ka lexuar aktakuzën dhe pasi gjyqtari u bind se e pandehura e ka kuptuar aktakuzën, bazuar në dispozitën e nenit 241 par. 4 të KPP-së të njëjtës i ofroi mundësinë që të pranojë fajësinë ose të deklarohet e pafajshme.

Në seancën e shqyrtimit fillestar e pandehura ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, se është e vetëdijshme për pranimin e fajësisë dhe pasojat e këtij pranimi, duke shtuar se i vjen keq për rastin që ka ndodhur, kërkon falje dhe premton se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla apo të ngjashme.

Pasi që e pandehura në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë, konform nenin 242 par.5 të KPP-së gjyqtari ka marrë mendimin e Prokurorit të Shtetit, i cili deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, pasi që ky pranim është në pajtim të plotë me nenin 242 të KPP-së dhe po ashtu është në harmoni të plotë edhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës, me të cilat vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj edhe i propozon gjykatës që ta miratoj pranimin e fajësisë. Ndërsa me rastin e shqiptimit të dënimit, gjykatës i propozon që si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethanë rënduese të merr për bazë shkallën e lartë të dashjes.

#### *Vlerësimi i gjykatës lidhur me pranimin e fajësisë.*

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar e pandehura dhe erdhi në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës është bërë në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPP-së dhe në pajtim edhe me faktet dhe provat që përmban aktakuza, njëherit vlerësoi se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë

vullnetarisht dhe mbështetet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike, dhe po ashtu gjykata sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 251 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme. Pasi gjyqtari i vetëm gjykuese u bind se e pandehura e ka kuptuar natyrën, benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe pasi që konstatoi se pranimi është në përputhje me nenin 242 par. 2 të KPP-së, me aktvendim e aprovoi pranimin e fajësisë së të pandehurës, për veprën penale vjedhje, nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Me qenë se e pandehura e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave në këtë çështje penale, por shqyrtimi fillestar ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar.*

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurës dhe nga provat të cilat i janë bashkangjitur shkresave të lëndës, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e të pandehurës formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje, nga neni 313 par.1 të KPRK-së, të përshkruar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e për të cilën veprë penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet dhe për këtë gjykata ka vendosur që të pandehurën ta shpall fajtores dhe t'i shqiptoj dënimin me burgim dhe me gjobë, të cilat dënime janë kushtëzuar më afër të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e saj penale juridike.

#### *Rrethanat me rastin e matjes dhe lartësisë së dënimit.*

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethanë lehtësuese vlerësoi faktin e pranimit të fajësisë nga e pandehura për veprën penale për të cilën akuzohet, keqardhjen e shfaqur nga e pandehura për rastin e ndodhur, kërkim faljen ndaj të dëmtuarit, pendimin për kryerjen e veprës penale, dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa si rrethanë rënduese përveç shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurës, gjykata rrethanë tjetër rënduese nuk ka gjetur.

Pasi që për këtë veprë penale parashihet dënim kumulativ me gjobë dhe me burgim, gjykata pas vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të elaboruara si më lartë, të njëjtës i shqiptoj dënimin me burgim dhe dënimin me gjobë të cilat dënime nuk do të ekzekutohet në afatin prej një viti, në rast se e njëjta brenda kësaj periudhe nuk kryen veprë të re penale. Gjykata përkitazi me dënimin me kusht mori për bazë keqardhjen e shfaqur për rastin që ka ndodhur, pendimin e shprehur dhe kërkim faljen, ku në prani të këtyre rrethanave, gjykata vlerëson se e pandehura e ka kuptuar rëndësinë e veprimeve të dëmshme, dhe në këtë mënyrë i dha edhe një mundësi të pandehurës të kushtëzohet në ekzekutim të dënimit, duke i lënë një periudhë të verifikimit prej një viti pasi që gjykata paraprakisht u bind se e njëjta nuk do të përsëritë veprimet e saj.

Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjyqtari është i bindur se dënimi i shqiptuar me kusht është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurës, duke marrë parasysh edhe faktin se e njëjta ka bërë pranimin e fajësisë, kështu gjykata vlerëson se me shqiptimin e

dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e veprës penale dhe të kryesit, po ashtu ky dënim do të shërbejë në parandalimin e të pandehurës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale), si dhe do të arrihet qëllimi që t'i përmbajë edhe personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

*Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike.*

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit palës së dëmtuar, gjykata e mori në kuptim të nenit 462 par.1 dhe 2 të KPP-së, ashtu që të pandehurën e obligoj që palës së dëmtuar t'i kompensojë dëmin e shkaktuar, të përcaktuar sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale.*

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës penale, në kuptim të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPP-së, obligoi të pandehurin që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjetë) euro. Po ashtu, konform nenit 36 par. 3 nën par. 3.1 të Ligjit Nr.08/L -109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të pandehurin të paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro) në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.1235/23 datë 13.12.2023

**Zyrtarja ligjore**  
Dife Latifi

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Bujar Ahmeti

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditëve prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.